

VENDIM
Nr. 151, datë 13.3.2018

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE
KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË PËR DHËNIEN ME
KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT PËR PROJEKTIN E RRUGËS
THUMANË-FUSHË-KRUJË-VORË-KASHAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, dhe në vijim të nenit 15 të rregullave për vlerësimin dhe dhënie me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen e rehabilitimin e rrugëve nacionale, miratuar me vendimin nr. 634, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 504, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 8,5 (tetë presje pesë) % të pikëve, që i jepet shoqërisë “Gener 2” për rezultatin teknik dhe financiar të propozimit të pakërkuar, të paraqitur për procedurën e koncesionit/partneritetit publik privat për projektin e rrugës Thumanë-Fushë-Krujë-Vorë-Kashar.
2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama